

## Pronësia Intelektuale dhe Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme: Vendosja e ideve në treg

Autore: Kujtesa Nezaj

Avokate dhe Përfaqësuese për Marka

Tregtare dhe Patenta



Konkurrueshmëria midis ndërmarrjeve sot matet më shumë përmes vlerësimit të Pronësisë Intelektuale (në tekstin në vazhdim referuar si "PI") apo aseteve të paprekshme sesa pronës së prekshe. Një ndërmarrje mund të ketë në pronësi toka, asete, si: makineri, kompjuterë apo asete të tjera, të cilat padyshim i japin vlerë ndërmarrjes së caktuar. Mirëpo, në raport me konsumatorin dhe konkurrentët e tjerë në treg, ajo që e vendos një ndërmarrje më lartë është padyshim produkti apo shërbimi që e ofron dhe risitë apo avancimet që i sjell me këto produkte/shërbime. Çdo ndërmarrje lufton që të sjell tek konsumatori produkte apo shërbime më të mira sesa ndërmarrjet konkurruese. Për realizim të këtij qëllimi, ndërmarrjet përdorin teknika inovative, metoda inovative të shitjes, paketime që janë më atraktive për konsumatorin, dhe të tjera të ngjashme, të cilat që të gjitha konsiderohen si PI e një ndërmarrje, dhe padyshim ndikojnë në rritjen e vlerës së një biznesi. Me qëllim të nënvizimit të këtij roli kyç, që të drejtat e pronësisë intelektuale luajnë në krijimin e ndërmarrjeve më të forta dhe më konkurruese, Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (në tekstin në vazhdim referuar si "WIPO") këtë vit ka shënuar Ditën

Botërore të Pronësisë Intelektuale me temën: Pronësia Intelektuale dhe Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme: Vendosja e ideve në treg. Tema e këtij viti ka qenë shumë relevante dhe e rëndësishme për Kosovën, meqë numrin më të madh të ndërmarrjeve e përbëjnë pikërisht ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të cilat kanë potencial të jashtëzakonshëm për të zhvilluar produkte dhe shërbime inovative, e të cilat mund të jenë objekt i mbrojtjes me ndonjë prej të drejtave të pronësisë intelektuale. Prandaj, ky artikull ka për qëllim që ndërmarrësve të rinj t'iu ofrojë disa këshilla se çfarë duhet të dinë apo çfarë duhet të kenë parasysh nëse dëshirojnë që të kenë një portfolio të suksesshme të të drejtave të pronësisë intelektuale.

### 1. Koha është thelbësore

Shpesh e dëgjojmë ose lexojmë se një ndërmarrës duhet të jetë i njoftuar me sistemin e PI-së dhe të ndërmarrë veprime për identifikimin dhe mbrojtjen e të drejtave të PI-së prej themelimit të biznesit. Në fakt, parimi i njohur se "koha është thelbësore" vlen jashtëzakonisht shumë kur kemi të bëjmë me mbrojtjen dhe zbatimin e suksesshëm të së drejtës së PI-së. Një vonesë, sado e vogël, në ndërmarrjen e një veprimi, mund të vendos biznesin e caktuar në disavantazh në raport me ndërmarrjet konkurruese. Një ndërmarrës duhet të jetë i njoftuar dhe të ndërmarrë veprime, si për zotërimin ashtu edhe për mbrojtjen e një të drejte të PI-së, para themelimit të ndërmarrjes dhe atë gjatë hartimit të planit të biznesit. Kjo për arsye se ndërmarrësit duhet të sigurohen se biznesi do të ketë në pronësi të gjithë PI-në e krijuar përgjatë aktivitetit biznesorë, dhe atë menjëherë

posa ajo PI të jetë krijuar. Kjo mund të bëhet, për shembull, përmes përfshirjes së klauzolave të PI-së në kontratat midis themeluesve të ndërmarrjes, në kontratat e shërbimeve me profesionistë të pavarur, shërbimet e të cilëve biznesi synon të përdorë, si dhe në kontratat e punës. Të gjitha këto veprime duhet të ndërmerren pa vonesë dhe para se të krijohet ndonjë vepër.

Parimi “koha është thelbësore” vlen gjithashtu edhe për regjistrimin apo mbrojtjen në kohë të një të drejte të caktuar të PI-së në vendin e caktuar. Sikurse do të shpjegohet në detaje më poshtë, në shumicën e vendeve, një e drejtë e caktuar e PI-së regjistrohet sipas parimit “i pari që e paraqet”. Kjo nënkupton që, pavarësisht nga përdorimi i një të drejte të veçantë të PI-së, nëse ndërmarrja nuk e regjistron me kohë të drejtën e saj tek autoritetet kompetente, ajo nuk e gëzon një të drejtë të tillë. Prandaj, është shumë e rëndësishme që biznesi të ketë një strategji të qartë për PI-në dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet e parashikuara nga ligji sa më shpejt të jetë e mundur.

## 2. Të drejtat e PI-së janë territoriale

Të gjitha të drejtat e PI-së janë të lidhura me një territor të caktuar. Kjo nënkupton se, fakti që një biznes apo ndërmarrje regjistron për shembull një markë tregtare apo një patentë në Kosovë, nuk do të thotë që do të gëzojë të njëjta të drejta edhe në një shtet tjetër. Regjistrimi në Kosovë vlen vetëm për territorin e Kosovës dhe anasjelltas, ndërsa regjistrimi në një vend tjetër vlen vetëm për atë vend. Për të gëzuar mbrojtje në territoret që janë në interes për biznesin, i njëjti duhet të regjistrojë të drejtën e caktuar pranë organeve kompetente

të atij shteti (përfshijmish të drejtën e autorit).

Çfarëdo e drejte e PI-së e regjistruar në disa vende përbën investim, dhe padyshim se është shumë e vlefshme për biznesin. Mirëpo, çdo regjistrim në një vend apo tjetër, sigurisht që mbart në vete edhe një kosto të caktuar. Prandaj, është shumë me rëndësi që një biznes të përcaktohet vetëm për territoret në të cilat mbrojtja e një të drejte të PI-së ka vlerë më të madhe për biznesin. Një ndërmarrje ka në pronësi një portfolio të suksesshme të PI-së nëse e gjithë pronësia intelektuale është identifikuar dhe mbrojtur në kohën dhe vendin e duhur.

Për shembull, është me rëndësi që një biznes të ketë regjistruar markën e produktit në vendet ku bën eksportimin e atij produkti apo në vendet ku mendon të eksportojë atë produkt në të ardhmen e afërt, apo në vendet ku mendon të gjenerojë profit nga eksploatimi i markës tregtare apo një të drejte tjetër të PI-së përmes licencimit. Prandaj, është jashtëzakonisht e rëndësishme që plani për zgjerimin e biznesit në territoret e tjera të bëhet paralelisht me mbrojtjen e të drejtave të PI-së në ato territore.

## 3. Ekzistojnë të drejta të ndryshme të PI-së

Për të krijuar një strategji të suksesshme të PI-së, ndërmarrësit duhet të kenë njohuri, të paktën bazike, për llojet e të drejtave të PI-së që janë në dispozicion, qëllimin e secilës prej tyre dhe mënyrën se si funksionojnë dhe ndërveprojnë këto të drejta njëra me tjetrën. Në mungesë të këtij vetëdijesimi, një ndërmarrës do ta këtë të vështirë të identifikojë se çfarë pronësie intelektuale tashmë ka krijuar

ndërmarrja e caktuar apo çfarë pronësie ka mundësi të krijojë. Për shembull, nëse një ndërmarrje ka krijuar një softuer kompjuterik për lehtësimin e një pune të caktuar, atëherë mund të kenë të drejtën e autorit për atë softuer kompjuterik. Ndërsa, nëse biznesi prodhon një produkt të caktuar apo ofron një shërbim nën një shenjë identifikuese, atëherë mund të ketë në pronësi një markë tregtare nën emrin apo logon e produktit apo edhe dizajnin industrial në pjesën estetike të paketimit të produktit, dhe ndoshta edhe të drejtën e autorit në logon origjinale të përdorur. Rrjedhimisht, identifikimi i saktë i pronësive intelektuale para së gjithash është proces që kërkon njohuri të caktuar të fushës. Ekzistojnë disa lloje të drejtave të PI-së. Shumica e bizneseve përdorin këto katër – patenta, marka tregtare, dizajnin industrial dhe të drejtat e autorit. Për të gjitha të drejtat e PI-së. të përmbledhura në vijim, ekzistojnë ligje të veçanta të cilat rregullojnë kushtet dhe procedurën për mbrojtjen dhe zbatimin e këtyre të drejtave.

Patenta për shembull është e drejtë ekskluzive e dhënë në lidhje me një shpikje, e cila mund të jetë një produkt ose një proces. Ajo i jep pronarit të patentës të drejtën për të ndaluar të tjerët të krijojnë produktin ose përdorin procesin përkatës që është objekt i mbrojtjes me patentë. Jo çdo shpikje mund të patentohet. Ekzistojnë disa kritere të natyrës materiale dhe formale që duhet të plotësohen në mënyrë që një shpikje të mund të mbrohet me patentë. Me kritere materiale nënkuptojmë që patenta do të jepet me kusht që shpikja të jetë e natyrës teknike; të përbëjë risi (mbarë botërore); të përmbajë hap shpikës; të jetë e aplikueshme në industri, si dhe të

mos jetë në grupin e shpikjeve të përjashtuara.

Ndërsa, me kushte formale nënkuptohet paraqitja e aplikimit për njohje të patentës pranë organeve kompetente të shtetit, në rastin e Kosovës, pranë Agjencisë për Pronësi Industriale (në tekstin në vazhdim referuar si “API”). Pra, e drejta në patentë fitohet pas regjistrimit pranë organit kompetent në vendin e caktuar.

Nuk është e mundur të merret një patentë mbarë botërore, por ka mekanizma që lehtësojnë procesin e aplikimit ose regjistrimit në më shumë se një vend, siç është sistemi i Traktatit të Bashkëpunimit të Patentave (PCT) dhe sistemi rajonal i Konventës së Patentave Evropiane (EPC). Megjithatë, edhe në raste të tilla, patentat aplikohen veçmas në secilin shtet të caktuar. Meqenëse një patentë mund të jepet vetëm për shpikjet që paraqesin risi, kompanitë këshillohen të mos e zbulojnë ose publikojnë shpikjen para se të paraqesin një kërkesë për patentë, sepse kjo mund të kufizojë mundësinë e mbrojtjes së patentës për atë shpikje.

Grupin tjetër i të drejtave të PI-së, dhe atë me shumë rëndësi për bizneset, e përbëjnë markat tregtare. Me markë tregtare nënkuptojmë çdo shenjë, e në veçanti fjalët, përfshirë emrat personal, skicimet, shkronjat apo/dhe numrat, forma e mallrave apo paketimet e tyre, ngjyrat apo kombinimi i të gjithave, e cila shërben si mjet identifikues i origjinës komerciale të një produkti apo shërbimi të caktuar. Pra, funksioni kryesor i një marke tregtare është identifikimi i origjinës përmes diferencimit apo dallimit të produkteve apo shërbimeve të një ndërmarrjeje nga produktet apo shërbimet e një ndërmarrjeje tjetër.

Sikurse tek patentat, edhe në rastin e markave tregtare duhet të plotësohen disa kushte të natyrës materiale dhe formale, në mënyrë që ndërmarrja e caktuar të mund të i realizojë të drejtat nga marka tregtare. Për shembull, si markë tregtare mund të regjistrohen vetëm shenjat që janë të dallueshme apo të veçanta, dhe që nënkupton se, shenjat të cilat mund të jenë përshkruese apo të përgjithshme në industrinë e caktuar, nuk mund të shërbejnë si marka tregtare. Pastaj, shenjat duhet të mos përmbajnë përmbajtje të paautorizuar, të mos jenë mashtruese, në rast se shenja përbëhet nga forma e produktit apo paketimi i produktit, të njëjtat nuk duhet të jenë funksionale, etj. Përveç këtyre pengesave, të cilat janë të natyrës absolute meqë qëllimi i tyre është mbrojtja e interesit të përgjithshëm, ekzistojnë edhe disa pengesa relative, qëllimi i të cilave është mbrojtja e interesit të ndërmarrjeve të cilat kanë të drejtat e tyre më të hershme. Rikujtojmë këshillën e parë: “koha është thelbësore”. Kështu, si markë tregtare, në parim, nuk do të mund të regjistrohet as shenja e cila është identike ose e ngjashme me markën tregtare të aplikuar apo regjistruar më herët nga një ndërmarrje tjetër. Qëllimi i kësaj pengese është pikërisht shmangia e hutisë apo konfuzionit tek konsumatori në lidhje me origjinën komerciale të një produkti apo shërbimi të caktuar. Mirëpo, një shenjë nuk do regjistrohet si markë tregtare për shkak se është e njëjtë apo e ngjashme me një markë të mëhershme vetëm nëse ndërmarrja që ka në pronësi markën e mëhershme do të paraqet kundërshtimin brenda afatit të paraparë. Prandaj, kompanitë këshillohen që të njihen me këto

procedura dhe të marrin masa proaktive për të identifikuar dhe vepruar në kohën e duhur kundër markave tregtare potencialisht shkelëse.

Të drejtat e markës tregtare janë të natyrës negative, që nënkupton se, për të përdorur një shenjë në tregti nuk është i obligueshëm regjistrimi. Megjithatë, pa një vendim të regjistrimit, ndërmarrja e cila është duke e përdorur shenjën e caktuar si markë tregtare nuk do të mund t'i ndalojë palët e treta që të përdorin shenjën e njëjtë apo të ngjashme me të tyren. Rrjedhimisht, të drejtat nga markat tregtare mund të i gëzojnë vetëm bartësit e markave të regjistruara tregtare. Gjithashtu, për një ndërmarrje është shumë me rëndësi që të bëhet dallimi midis emrit të biznesit apo emrit tregtar dhe markës tregtare. Regjistrimi i emrit të biznesit nuk nënkupton regjistrim të markës tregtare. Për më tepër, një biznes mund të ketë vetëm një emër biznesi i cili shërben për identifikimin e atij biznesi; ndërsa, mund të ketë në pronësi një numër të markave tregtare varësisht prej veprimtarisë së biznesit dhe zgjerimit të tij, e gjithë kjo me qëllim të dallimit të produkteve apo shërbimeve të ndërmarrjes. Prandaj, keni parasysh se, duke regjistruar një biznes nuk do të thotë se keni regjistruar automatikisht një markë tregtare dhe, rrjedhimisht, nuk mund t'i ndaloni të tjerët të përdorin të njëjtën markë tregtare ose të ngjashme.

Dizajnët industrial gjithashtu i përkasin drejtave të PI-së. Qëllimi i tyre është mbrojtja e karakteristikave estetike apo zbukuruese të produktit. Për dallim nga patentat, të cilat mbrojnë karakteristikat teknike inovative të një produkti, dizajni industrial mbron pamjen e jashtme të produktit.

Me të drejtën e dizajnit industrial mbrohet dizajni deri në atë shkallë në të cilën është i ri dhe ka karakter individual. Pra, risia dhe karakteri individual përbëjnë kriteret materiale të cilat duhet të përmbushen. Sikurse edhe të drejtat e tjera të pronësisë industriale, dizajni industrial duhet të regjistrohet pranë organit kompetent në vendin e caktuar, në mënyrë që bartësi të gëzojë të drejtat që dalin nga ai ligj. Bartësi i dizajnit industrial ka të drejtë të ndalojë të gjitha palët e treta nga përdorimi i dizajnit identik apo ndonjë dizajn tjetër i cili nuk krijon përshtypje të ndryshme tek shfrytëzuesi i informuar.

Kategori tjetër e të drejtave të PI-së, gjithashtu e rëndësishme për bizneset, është padyshim e drejta e autorit dhe të drejtat e përafërta. Me të drejtën e autorit mbrohet shprehja apo paraqitja e një ideje të caktuar. Pra, nuk mbrohet vetë ideja, por mënyra se si është shprehur apo prezantuar ajo ide. Për dallim nga të drejtat e pronësisë industriale sikurse janë patentat, markat tregtare apo dizajnet industriale të cilat fitohen në momentin e regjistrimit, e drejta e autorit mbi një vepër të caktuar fitohet me vetë krijimin e veprës. Pra, nuk është i nevojshëm regjistrimi i krijimtarisë pranë ndonjë organi administrativ. Megjithatë, sikurse edhe tek të drejtat e tjera, edhe në rastin e të drejtave të autorit duhet të plotësohen kushtet e përcaktuara me ligj, në mënyrë që një vepër të konsiderohet vepër e mbrojtur. Për të u kualifikuar për mbrojtje, lënda duhet të jetë vepër në lëmin e literaturës, shkencës apo artit, si dhe së dyti, lënda duhet të jetë origjinale në kuptimin që është krijim intelektual i autorit. Meqë nuk kërkohet regjistrimi, kriteri i origjinalitetit supozohet derisa të mos provohet e kundërta në procedurë

gjyqësore.

E drejta e autorit është e aplikueshme për vepra të ndryshme, të cilat në disa raste për shkak të natyrës së tyre mund të konsiderohen si vepra jo të natyrës komerciale, apo thënë ndryshe, nuk pritet që një biznes të ketë të bëjë me ato vepra. Mirëpo, sikurse mund të vërehet edhe nga tabela e mëposhtme, të drejtat e autorit ndërthuren jashtëzakonisht shumë me veprimet e një biznesi, saqë një neglizhencë e vogël në këtë drejtim, mund të i kushtojë biznesit jashtëzakonisht shumë. E drejta e autorit ngërthen në vete disa të drejta, siç janë: e drejta e riprodhimit, shpërndarjes, dhënies me qira, përpunimit, adaptimit, etj., të cilat mund të administrohen dhe transferohen bashkërisht apo ndaras nga njëra tjetra. Pra, autori mund të t'ia transferojë të drejtën e riprodhimit të veprës së caktuar ndërmarrjes A, ndërsa të drejtën e adaptimit ndërmarrjes B. Prandaj, ndërmarrja duhet të sigurohet që në marrëveshjet me autorët e veprave të cekin në mënyrë specifike se cilat të drejta ekonomike saktësisht autori ia transferon në pronësi ndërmarrjes tjetër.

Lloji i PI-së	Cfarë mund të mbrohet?	Qëllimi
Markë tregtare	Shenjat identifikuese, siç janë : emri i biznesit, logot, emrat e produkteve, format apo paketimet e produkteve, ngjyrat e paketimeve dhe kombinimi i të gjithave	Identifikon produktet/ shërbimet e ndërmarrjes dhe i dallon ato prej produkteve/shërbimeve të ndërmarrjeve tjera.
Patentë	Produktet apo proceset e reja.	Mbron karakteristikat teknike inovative të një produkti.
Dizajn industrial	Paketimet e produkteve apo forma e produktit	Mbron pamjen e jashtme/ vizuale apo estetike të produktit.
E drejta e autorit	Përbajtja kreative, materialet e shkruara, fotografitë, videot, logot, ueb faqet, bazat e të dhënave, softuerët kompjuterik, etj.	Mbron shprehjen apo paraqitjen origjinale të idesë.

#### 4. Përfshirja e klauzolave të PI-së në kontrata

Të gjitha objektet e pronësisë intelektuale/industriale krijohen nga personat fizik. Për shembull, fotografia shkrepet nga një fotograf, si i vetëpunësuar apo punonjës në një ndërmarrje të caktuar.

Pastaj, shpikja e një produkti të ri bëhet nga shpikësi. Logoja apo dizajni i një produkti të caktuar, që mund të shërbejë si markë tregtare apo edhe dizajn industrial, dizajnohet nga disenjatori si person fizik. Prandaj, në parim, pronësia u takon atyre personave që e kanë krijuar atë vepër apo kanë shpikur ndonjë risi, e të ngjashme, përveç nëse është përcaktuar ndryshe sipas kontratës ose ligjit.

Në mungesë të marrëveshjes, çështja e përcaktimit të pronësisë jo gjithmonë është aq e thjeshtë sa mund të duket. Nëse marrim si shembull markat tregtare figurative të cilat në vete përmbajnë elemente artistike origjinale, një shenjë e tillë mundet padyshim të mbrohet si markë tregtare, mirëpo edhe me të drejtën e autorit. Në rast të përdorimit të paautorizuar të kësaj shenje nga një ndërmarrje tjetër, pretendimet për shkeljen e së drejtës së markës tregtare apo të drejtës së autorit mund të marrin kahe të ndryshme sa i përket çështjes së provimit të pronësisë dhe, rrjedhimisht, përdorimit të paautorizuar. Si ndodh kjo?

Ndërmarrja apo biznesi që pretendon shkeljen, pra paditësi, duhet para së gjithash të provojë që ka të drejtë të iniciojë rastin, pra është bartësi i së drejtës. Në pretendimin për shkeljen e markës tregtare, bartës është ndërmarrja në emër të së cilës është lëshuar vendimi për regjistrimin e markës tregtare. Prandaj, me kusht që të ekzistojë regjistrimi i markës tregtare, barra e provës përmbushet shumë lehtë. Mirëpo, kjo nuk nënkupton që e njëjta ndërmarrje është edhe bartëse e së drejtës së autorit për atë logo. Rikujtojmë që në rastin e të drejtës së autorit, nuk është

i nevojshëm regjistrimi. Prandaj, çështja e provimit të pronësisë të së drejtës së autorit mund të ndërlikohet në rast se nuk ekziston një marrëveshje midis autorit dhe biznesit. Kjo për faktin se bartës i parë është gjithgjithmonë autori i cili ka krijuar logon (vlen edhe për patenta dhe dizajnë industriale).

Për të shtyrë përpara pretendimin për shkeljen e së drejtës së autorit, ndërmarrja duhet të provojë që është bartës i së drejtës së autorit sipas kontratës për bartje midis ndërmarrjes dhe autorit. Në mungesë të kontratës për bartje, ndërmarrja duhet të provojë se është bartës i së drejtës së autorit sipas ligjit, përkatësisht ajo logo është krijuar nga marrëdhënia e punës apo sipas kontratës mbi vepër. Nëse nuk arrin të provojë një marrëdhënie të tillë, atëherë nuk do të ketë sukses në pretendimet për shkelje të së drejtës së autorit.

Rasti më lartë paraqet më së miri rëndësinë e kontratave, në përgjithësi, dhe klauzolave të PI-së, në veçanti, për t'u siguruar që pronësia mbi një të drejtë të caktuar të PI-së është transferuar tek ndërmarrja apo biznesi. Kështu, në mënyrë që ndërmarrja apo biznesi të jetë para së gjithash pronari i vetëm i cilësdo të drejtë të PI-së të krijuar përgjatë veprimtarisë së biznesit, të njëjtit duhet të sigurohen që marrëveshja midis themeluesve për krijimin e ndërmarrjes, pastaj marrëveshjet me kontraktuesit apo kontratat mbi vepër, mirëpo edhe kontratat e punës të përfshijnë klauzolën e transferimit apo bartjes së një të drejtë të caktuar të PI-së tek ndërmarrja tjetër. Biznesi duhet të jetë pronari i vetëm i çdo PI-je dhe asnjë supozim i pronësisë nuk duhet të lejohet.

Krijuesi i një veprë të caktuar, shpikësi ose disenjatori, që nga fillimi i marrëdhënies kontraktuale, duhet të jenë të vetëdijshëm se e gjithë e drejta, titulli dhe interesat e një të drejte të caktuar të PI-së do t'i jepen vetëm ndërmarrjes dhe jo personit i cili në të vërtetë e ka krijuar atë PI.

Këto klauzola gjithashtu sigurojnë që në rast të largimit të themeluesit apo punonjësit të caktuar, çfarëdo PI e krijuar mbetet në pronësi të ndërmarrjes apo biznesit. Në mungesë të një klauzole të tillë, ligjet e aplikueshme përcaktojnë rregullat të cilat mund të rregullojnë një marrëdhënie të tillë. Mirëpo, dispozitat që e rregullojnë këtë raport janë shumë të kufizuara dhe, rrjedhimisht, përcaktimi me kohë i kriterëve apo politikave të qarta nga bizneset në lidhje me pronësinë përmes marrëveshjeve është jashtëzakonisht i rëndësishëm.

### **5. Shmangia nga përdorimi i paautorizuar i PI-së**

Sa është e rëndësishme që një ndërmarrje të identifikojë dhe mbrojë asetet që mund të jenë objekt i mbrojtjes me të drejtat e PI-së, po aq e rëndësishme është që ndërmarrja të sigurohet se me veprimet e caktuara nuk po shkel në territor të huaj. Pra, duhet të sigurohet se nuk po përdor pa autorizim të drejtat e PI-së që i përkasin një ndërmarrjeje tjetër. Me qëllim që të shmangni përdorimin e paautorizuar dhe pranimin e kërkesave për ndalim të shkeljes nga të tjerët, ndërmarrja duhet para së gjithash të sigurohet që të këshillohet me profesionistë të fushës në lidhje me pengesat që mund të ekzistojnë varësisht nga lloji i PI-së, duke bërë një

hulumtim paraprak të regjistrave apo edhe vetë tregut të caktuar. Në këtë mënyrë biznesi do të shmangte investimet e panevojshme të cilat mund të jenë të konsiderueshme kur kemi të bëjmë me mbrojtjen e të drejtave të PI-së në vendet e interesit.

Bizneset duhet gjithashtu të jenë në dijeni se mungesa e njohurive nga ndërmarrja apo ndërmarrësi nuk e përjashton përgjegjësinë. Ndryshimet jo thelbësore apo minimale midis markave për shembull, nuk e shmangin përgjegjësinë. Gjithashtu, fakti që një vepër, si p.sh. fotografi, video apo të ngjashme, është publikuar në internet apo janë lehtë e shkarkueshme, nuk do të thotë që ndodhen në domenin publik dhe se mund të përdoren pa autorizim. Prandaj, ndërmarrësi duhet të sigurohet që në veprimtarinë e tij të biznesit të përdor vetëm veprën me përmbajtje të autorizuar.

Për të përmbledhur, mbrojtja adekuate e PI-së së një ndërmarrjeje është një hap vendimtar për parandalimin e shkeljes së mundshme dhe për kthimin e ideve në pasuri biznesi me një vlerë të caktuar. Shfrytëzimi i plotë i sistemit të PI-së u mundëson ndërmarrjeve të përfitojnë nga kreativiteti i tyre inovativ, i cili inkurajon dhe ndihmon në financimin e risive të mëtejshme. Prandaj, është shumë me rëndësi që të gjithë ndërmarrësit ta konsiderojnë mbrojtjen e të drejtave nga PI-së si investim dhe jo shpenzim dhe, rrjedhimisht, të planifikojnë mbrojtjen e këtyre të drejtave që nga hapat e parë të veprimtarisë, dhe sigurisht të i paraprijnë shkeljeve apo përdorimeve të paautorizuara nga të tjerët.